



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____._____.2022

VENDIM
Nr. 39, datë 28.01.2022

PËR
CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË
VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË
FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 90/3 e 95 të Kodit të Procedurave Administrative, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në nenin 170/1 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

VENDOSI:

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR POGRADEC

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Besnik Shehu, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec; I pandehur: {...}; Objekti: “Kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR LEZHË

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Gentian Jahjollli, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, çështjen penale me të pandehur: {...}, {...}; Akuza: “Dërgimin në gjyq të procedimit penal nr.598/2020 në ngarkim të të pandehurve {...}, {...}, të akuzuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 130/a/1 e 277 të Kodit Penal”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR BERAT

Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat si vijon:

1. Kërkesës nr. 1685 prot., datë 02.12.2021, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore me të pandehur: {...} {...} I akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 100/2 i Kodit Penal.

GJYKATA E APELIT KORÇË

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë, Ilir Toska, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit”.
2. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë, Elona Toro dhe Ilir Toska, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}, etj.; Akuza: “Ndihmë për kalim të paligjshëm të kufijve”.
3. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë, Elona Toro dhe Ilir Toska, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Prodhim dhe shitja e narkotikëve”.
4. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë, Elona Toro dhe Ilir Toska, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}, etj.; Akuza: “Ndihmë për kalim të paligjshëm të kufijve; “Falsifikim dokumenti”; “Drejtim automjeti në mënyrë të parregullt”.

GJYKATA E APELIT SHKODËR

1. Gjyqtaret e Gjykatës së Apelit Durrës, Anita Mici dhe Irida Kacerja, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Nenet 284/2, 278/3, etj. të Kodit Penal”.
- II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR